



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 675, datë 08.11.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN DHE LEJIMIN PËR TË MARRË PJESË NË PROVIMIN E VLERËSIMIT
PROFESIONAL TË KANCELARIT NË DETYRË NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, Z.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 83, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore e ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i procedurës së verifikimit znj. Fatmira Luli, mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës të kancelarit në detyrë, z. {...},

VENDOSI:

1. Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kancelarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR